



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARUA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Njësia Orig. Org. Jediti. Org. Unit	01
Ne Prot. Bz. Prot. Prot. No.	210
Ne ifaqe Broj stranica No. pages	02
Data Datum Date	13.11.2012
PRISHTINË/A	



Nr. prot. 36/2012
Datë: 13.11.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) mbikëqyrësi kryesor shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. Këshillohet institucioni i arsimit të lartë 'AAB' të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Institucioni i arsimit të lartë 'AAB' në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 05.11.2012, Agjencia ka realizuar kontrollin sipas detyrës zyrtare në institucioni i arsimit të lartë 'AAB'. Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.11/2012, i cili është nënshkruar nga personi përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Gjatë kontrollit që është bërë në institucionin e arsimit të lartë 'AAB' është konstatuar se është i instaluar sistemi i vëzhgimit me kamerë, janë të vendosura njoftimet (fletëla jmrmet), nuk është nxjerrë vendimi për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë dhe se në katër objektet janë të vendosura 49 kamera.

Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose aty ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi kryesor shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ruzhdi Jashari
Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror



Vendimi i dërgohet:

- Institucionit të arsimit të lartë 'AAB'
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë